



Pranuar / Dërrëzuar Përmbluar / Preritur Received / Delivery		10.03.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKM/SH/01	1287/2022		1/4	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.87/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.87/2022 të datës 02.02.2022 të parashtruar nga ankuesi [Blank] të cilin me autorizim e përfaqëson Avokati [Blank] me adresë [Blank] pa numër në Komunën e Podujevës, kundër Vendimit me Nr. 02-400/01-0036222/21 të datës 05.05.2021 të Kryetarit të Komunës së Podujevës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 10.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.87/2022 e datës 02.02.2022 e parashtruar nga ankuesi [Blank]

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit [Blank] i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 01.01.2016 në pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Sociale" në Komunën e Podujevës, Menaxheri i Personelit me datë 06.04.2021 ka nxjerr Vendim me Nr.13-118/02-0030449/21 për përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuesit për shkak të arritjes së moshës së pensionimit nga data 15.04.2021, ndërsa Kryetari i Komunës së Podujevës më datë 05.05.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 02-400/01-0036222/21 me të cilin lejohet kompensimin i një page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit 550.57 Euro për ankuesin në emër të pensionimit.

Ankuesi, kundër Vendimit me Nr. 02-400/01-0036222/21 të datës 05.05.2021 të Kryetarit të Komunës së Podujevës, përmes përfaqësuesit të tij me postë më datë 31.01.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar më datë 02.02.2022 dhe është regjistruar me numër të ankesës A.nr.87/2022 me numër protokolli 493/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Komunën e Podujevës. Më datë 23.02.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Podujevës bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/12.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 02.02.2022 me numër protokolli 493/2022 të datës 02.02.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 02-400/01-0036222/21 të datës 05.05.2021 të Kryetarit të Komunës së Podujevës; Autorizimi i datës 14.06.2021 për përfaqësim; Vërtetim i noterizuar LRP.Nr.5948/2021, Kopja e letërnjoftimit, Zarfina e datës 31.01.2022, Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 09.02.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 22.02.2022 nga organi i punësimit; Akt Emërimit e datës 01.01.2016 në emër të ankuesit; Vendimin me Nr. 13-118/02-0030449/21 i datës 06.04.2021 për përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuesit i nxjerrë nga Menaxheri i Personelit; Urdhër Pagesën përmes Ministrisë së Financave-Thesarit për pagesën e vlerës 550.57 Euro, Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 15.04.2021, Kërkesë e parashtruar në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Podujevës për kompensimin e pagave përcjellëse dhe pagave jubilarë në vlerë prej 2450 euro, Letër konfirmim i datës 09.01.2020 nga kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës; E-mail zyrtar i datës 28.02.2022 dhe lista e pagave e datës 01.12.2013.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e palejuar, sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 02-400/01-0036222/21 të datës 05.05.2021 të Kryetarit të Komunës së Podujevës me të cilin lejohet kompensimi i një page mujore të njehershme në vlerën e pagës së fundit 550.57 Euro me rastin e pensionimit, pretendon që kompensimi është dashur të bëhet sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive në emër të tri pagave përcjellëse dhe tri pagave jubilarë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në kërkesën për përgjigje në ankesë të dërguar tek Komuna e Podujevës më datë 09.02.2022 ka kërkuar dëshmi lidhur me ankesën e ankuesit *"Ankesën e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe Vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave"*, mirëpo

Komuna e Podujevës në përgjigjen në ankesë të datës 23.02.2022 nuk ka dërguar asnjë provë të tillë, pastaj më datë 28.02.2021 përmes E-mailit zyrtar kemi kërkuar edhe njëherë këtë dëshmi, mirëpo Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore i Komunës së Podujevës ka njoftuar që: *“Nuk kemi asnjë dëshmi se ankuesi ka parashtruar ankesë në komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave”*.

Në bazë të Vendimit me Nr. 13-118/02-0030449/21 i datës 06.04.2021 për përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuesit dhe Vendimit me Nr. 02-400/01-0036222/21 të datës 05.05.2021 të Kryetarit të Komunës së Podujevës, pala e pakënaqur kundër këtyre vendimeve ka pasur të drejtë të ankohet në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës brenda 30 ditësh, mirëpo Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se bazuar në provat e lëndës nuk ka dëshmi që kur ankuesi e ka pranuar Vendimin me Nr. 13-118/02-0030449/21 i datës 06.04.2021 për përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuesit, mirëpo në provat e lëndës si dëshmi është Urdhër Pagesa e datës 09.06.2021 me të cilën dëshmohet se ankuesit i është bërë kompensimi i një page të njëhershme në vlerën 550.57 euro, po ashtu ankuesi përfaqësuesin e tij për përfaqësim në gjykata dhe institucionet të tjera sipas autorizimit e ka autorizuar të përfaqësoj më datë 14.06.2021, që është argument i mjaftueshëm për të konstatuar faktin se ankuesi ka pasur të njohur faktin se i është bërë pagesa e vetëm një page, e jo aq sa i takojnë sipas pretendimit të ankuesit duke u bazuar në kontratën kolektive.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se ankuesi ka qenë në dijeni me kohë për aktet juridike të nxjerra nga Komuna e Podujevës e që kanë të bëjnë me përfundimin e marrëdhënies së punës respektivisht me kompensimin e mjeteve në llogarinë e tij bankare sipas Vendimit me Nr. 02-400/01-0036222/21 të datës 05.05.2021 të Kryetarit të Komunës së Podujevës, si rrjedhojë kjo përbën fakt juridik që ankuesi me rastin e pranimit të kompensimit ka qenë i njoftuar për këto veprime.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këshillën juridike të Vendimit me Nr. 13-118/02-0030449/21 i datës 06.04.2021 për përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuesit dhe Vendimit me Nr. 02-400/01-0036222/21 të datës 05.05.2021 të Kryetarit të Komunës së Podujevës, si dhe faktin që në muajin qershor 2021 i është bërë kompensimi i një page të njëhershme me rastin e pensionimit, këto vendime kanë prodhuar efektet juridike sipas nenit 51 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Një akt administrativ fillon të prodhojë pasojat juridike në raport me palën të cilës i drejtohet apo e cila cenohet nga ai, me njoftimin e përmbajtjes të tij”*, si rrjedhojë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar përmes postës më datë 31.01.2022 përmes përfaqësuesit të tij në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është në kundërshtim me dispozitat e nenit 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: “heshtja*

administrative””, dhe nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”, andaj ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji”, në këtë rast ankesa e ankuesit është e parashtruar jashtë afatit ligjor sipas dispozitave të lartcekura.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.87/2022, datë 10.03.2022

Sabile AVDYLI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Përfaqësuesit të ankuesit
- ❖ Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- ❖ Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës; dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

